

Testimi psikologjik

1. Testimi psikologjik zhvillohet me qëllim që të verifikojë te kandidatët përgjegjshmërinë, motivimin, aftësinë e të menduarit dhe të gjykuarit, si dhe stabilitetin e sjelljes.
2. Testi psikologjik zhvillohet nën mbikëqyrjen e komisionit të testimit psikologjik. Ai zhvillohet pas testimit intelektual.
3. Testi psikologjik zhvillohet në formë interviste dhe është skualifikues. Në çdo rast, arsyet e skualifikimit të kandidatëve motivohen me shkrim.
4. Në përfundim të testimit psikologjik, komisioni përkatës i dërgon komandantit të QPR-së “Raportin e rezultateve të testimit psikologjik”. Raporti përmban: nr., emrin, atësinë, mbiemrin e kandidatit, rezultatet e testimit psikologjik dhe statusin e kandidatit në përfundim të testimit psikologjik “kalues” ose “mbetës”.
5. Pas hedhjes së rezultateve të testimit psikologjik në sistemin e automatizuar të të dhënave nëpërmjet sistemit gjenerohet “Raporti i kandidatëve fitues në testimin fizik, intelektual dhe psikologjik”, i cili do t’i dërgohet zyrtarisht NJMU-së për kryerjen e kontrollit shëndetësor të kandidatëve, brenda dy ditëve nga nxjerrja e rezultateve.